



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

Shqyrtimi i shtatë i tarifës së energjisë elektrike

SHTE7 (2013-2017)

Detajet mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe të Furnizuesit Publik

22 mars 2013

Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara kapitale të OSSH-së	4
2.1	Propozimet e Shpenzimeve kapitale të OSSH-së	4
2.2	Parashtresa e Çalik-Limak për shpenzimet kapitale të OSSH-së.....	5
2.2.1	Çalik-Limak propozon rishqyrtimin e rrjetit dhe prioriteteve të tij	5
2.2.2	Çalik-Limak sugjeron që kostot për njësi duhet të jenë ato që propozon kompania	5
2.2.3	Kërkesa për vlerën e plotë, të propozuar të capex-it	6
2.3	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së i shpenzimeve kapitale të OSSH-së.....	6
3	Vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve operative të propozuara të OSSH-së	7
3.1	Pagat dhe kostot e ndërlidhura.....	7
3.1.1	Parashtresa e KEK-ut për paga dhe kosto të ndërlidhura	7
3.1.2	Parashtresa e Çalik-Limak për pagat dhe kostot e ndërlidhura	7
3.1.3	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për pagat dhe kostot e ndërlidhura.....	8
3.2	Riparimet dhe mirëmbajtja	8
3.3	Opex-i tjetër i kontrollueshëm.....	9
3.4	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për propozimet e shpenzimeve operative të OSSH-së ..	10
4	Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara kapitale të FPEE-së	10
5	Vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve të propozuara operative të FPEE-së	11
5.1	Niveli i stafit	11
5.2	Paga dhe kostot e ndërlidhura	11
5.3	Riparimet dhe mirëmbajtja	11
5.4	Kostot tjera të kontrollueshme	12
5.5	Parashtresa e Çalik-Limak lidhur me shthurjen	12
5.5.1	Pagat.....	13
5.5.2	Opex-i tjetër	13
5.5.3	Kostot e konsulencës.....	13
5.6	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së lidhur me propozimet e FPEE-së për shpenzimet operative	14

6	Parametrat e tjerë rregullativ	14
6.1	Lejimi për humbje	14
6.2	Faktori i ndarjes së humbjeve	15
6.3	Faktori i efikasitetit	15
6.4	Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitali (MPKK)	15
7	MAR-i përfundimtar 2013-2017	15

1 Hyrje

Në një letër të datës 8 qershor 2012, ZRRE-ja paralajmëroi fillimin e Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike 7 (SHTE7), i cili, për herë të parë, do të mundësojë përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarëve për periudhë shumë vjeçare. Këto të ardhura maksimale të lejuara do të duhej, me ligj, të ishin të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kapitale të kryerjes së aktiviteteve të licencuara.

Në harmoni me Rregullat e publikuara, ZRRE ka shqyrtuar me kujdes kostot e parashikuara të të licencuarve. KEK-ut i është kërkuar që të prezantojë parashtrësën ZRRE-së dhe publikut më 3 shtator. Që nga ajo datë, ZRRE ka punuar shumë për së afërmi me kompaninë për të qartësuar parashtrësat fillestare për të licencuarit Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesin Publik (FPEE).

ZRRE ka bërë një vlerësim të përkohshëm të kostove të KEK-ut dhe ka përmbledhur konstatimet në Propozimet e Përkohshme për shqyrtimin TSHV, të lëshuar më 8 janar 2013. Në përgjigje të Propozimeve të Përkohshme të ZRRE-së, janë pranuar parashtrësat lidhur me OSSH-në dhe FPEE-në nga vet KEK-u dhe nga Calik – Limak (C-L), ky i fundit blerësi i ardhshëm i bizneseve të shpërndarjes dhe të furnizimit të KEK-ut. Këto parashtrësa janë pranuar nga ZRRE më 4 shkurt 2013. C-L dhe KEK-u kanë kërkuar ndryshimin e qëndrimit të ZRRE-së, siç është përcaktuar me Propozimet e Përkohshme, sa i përket disa kostove dhe supozimeve që janë përdorur si bazë për llogaritjen e MAR-eve. Për të dyja parashtrësat, ZRRE komenton në këtë Vlerësim Përfundimtar dhe iu jep përgjigje pikave të cilat janë kontestuar nga ata.

Ky dokument është pjesë përbërëse e Vlerësimit përfundimtar të ZRRE-së dhe duhet të lexohet bashkërisht me “Vlerësimin Përfundimtar – Pasqyrë” të publikuar krahas këtij dokumenti dhe shtojcave të tij. Ai është strukturuar si vijon:

Pjesa 2 – Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara kapitale të OSSH-së

Pjesa 3 – Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara operative të OSSH-së

Pjesa 4 – Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara kapitale të FPEE-së

Pjesa 5 – Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara operative të FPEE-së

Pjesa 6 – Parametrat e tjera rregullative

Pjesa 7 – MAR-i përfundimtar për OSSH dhe FPEE

2 Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara kapitale të OSSH-së

2.1 Propozimet e Shpenzimeve kapitale të OSSH-së

Më 19 tetor 2012, ZRRE lëshoi një dokument konsultimi (“Konsultimi i tetorit”) ku, ndër të tjera, përvijëzohet kuptimi i parashtresës së OSSH-së deri më sot dhe kërkoi sqarime dhe arsytetime shtesë. ZRRE deklaroi se pa arsyetim të duhur të kostove të OSSH-së si dhe shpjegimeve të mospërputhjeve, ZRRE do t’i konsiderojë disa elemente të kostos si të paarsyeshme dhe t’i përjashtojë nga llogaritja e MAR-it.

Parashtresa e nëntorit e OSSH-së përbëhej nga një listë e projekteve që kapin shumë totale prej €114.1m të cilat duhet të zbatohen gjatë Periudhës Rregulative prej pesë viteve. OSSH planifikoi që ta shpërndajë në mënyrë të barabartë këtë plan të shpenzimeve kapitale përgjatë çdo Viti Relevant të Periudhës Rregulative, ku investimet do të variojnë prej €22m deri në €23m në vit.

Vlerësimi teknik i shpenzimeve kapitale të OSSH-së, i përgatitur nga konsulentët teknik të ZRRE-së, SKM, vuri në pah që plani i investimeve të OSSH-së ishte në përputhje me Planin e Zhvillimit të Rrjetit të të licencuarëve dhe se shpenzimet kapitale ishin bazuar mbi kërkesat e rrjetit si dhe prioriteteve të OSSH-së. Për më tepër, modeli i Shpenzimeve të ndërlidhura me ngarkesën si dhe Shpenzimet që nuk ndërlidhen me ngarkesën sugjerojnë se nivelet e shpenzimeve kapitale ishin nën nivelet e pritshme, duke marrë parasysh profilizimet aktuale të vjetërsisë së aseteve, madje edhe me supozimet më optimiste lidhur me jetëgjatësinë e aseteve. ZRRE-ja u pajtua me këtë vlerësim.

Parashtresa e shpenzimeve kapitale të OSSH-së i është nënshtruar verifikimi të mëtejshëm rigoroz për të vlerësuar nëse kostot për njësi për çdonjërin nga projektet e shpenzimeve të propozuara kapitale të tyre janë në përputhje me krahasues relevantë ndërkombëtarë. Të dhënat nga vlerësimi teknik sugjeruan që kostot për njësi të OSSH-së, siç ishin raportuar nga KEK-u në parashtresën e tyre të nëntorit, ishin më të larta se sa ato që priten, në veçanti ato për linjat ajrore (të të gjitha tensioneve) si dhe kabllot 400 V. Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i 8 janarit kërkoi që KEK-u të ofrojë të dhënat mbështetëse për të konfirmuar këto kosto të larta.

Më 4 shkurt 2013, KEK-u është përgjigjur me të dhëna shtesë për kosto për njësi. Në vend që të mbështesin kostot më të larta të cekura në parashtresën e tyre fillestare, ka rezultuar qartë që kostot aktuale janë dukshëm nën këtë nivel. Këto të dhëna të rishqyrtuara janë shqyrtuar nga konsulentët teknik të ZRRE-së dhe ata e kanë ndryshuar vlerësimin e tyre. Aplikimi i të dhënave të ndryshuara të KEK-ut për Planin e Zhvillimit të Rrjetit 2013 – 2017 sugjeron që kostot kapitale të KEK-ut do të jenë 107.2 milionë €. Kjo është nën vlerën e €114m të propozuar fillimisht nga KEK-u por është për €8.2 milionë më e lartë se kostot kapitale prej 99 milionë € të lejuara në Vlerësimin e përkohshëm të ZRRE-së.

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

Tabela a

Programi i propozuar kapital i OSSH-së duke përdorur informatat e azhuruara mbi koston e njësisë (shkurt 2013)	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	2017 € 000's	Total € 000's
Plani i zhvillimit të rrjetit të OSSH-së (PZHRR) duke përdorur kostot e propozuara të KEK-ut	22,540	22,343	23,403	22,952	22,867	114,105
PZHR përfundimtar i OSSH-së duke përdorur të dhënat e ndryshuara të koston për njësi shkurt 2013	21,646	21,233	21,393	21,557	21,420	107,250
Ndryshimi (€ 000's)	-894	-1,110	-2,010	-1,395	-1,447	-6,855

2.2 Parashtrësia e Çalik-Limak për shpenzimet kapitale të OSSH-së

Blerësi i ardhëshëm i bizneseve të shpërndarjes dhe të furnizimit të KEK-ut, Çalik-Limak, gjithashtu bëri një parashtrësë me shkrim në ZRRE pas konsultimeve të janarit 2013 lidhur me vlerësimin e përkohshëm të ZRRE-së. Çalik-Limak ngriti një numër çështjesh në lidhje me Investimet kapitale të OSSH-së. Ata sugjeruan se një rivlerësim i prioriteteve të investimeve të rrjetit do ishte i qëlluar, në mënyrë që të identifikohen fushat kyçe ose problematike. Ka pasur dy propozime të tjera të cilat do të ndikonin drejtpërsëdrejti në lejimet për shpenzimet kapitale (Capex) të dhëna në Propozimet e përkohshme të ZRRE-së. C-L tha se kostot për njësi në Kosovë karakterizohen me konkurrencë të kufizuar dhe varësi të lartë nga importi dhe prandaj duhet të lejohen në nivelet e propozuara nga i licencuari. Ai gjithashtu sugjeroi se do të ishte e përshtatshme të mbahen lejimet për Investimet kapitale në nivelet e propozuara nga kompania, ku çfarëdo kursimesh do të ridrejtoheshin për projektet tjera për përmirësimin e rrjetit.

Përgjigja e ZRRE-së për çështjet më kryesore të parashtruara nga Çalik-Limak janë si në vijim:

2.2.1 Çalik-Limak propozon rishqyrtimin e rrjetit dhe prioriteteve të tij

ZRRE beson se një shqyrtim i tillë do të ishte një hap pozitiv për OSSH-në. ZRRE më herët ka bërë me dije se si do t'i trajtonte rezultatet e një rishqyrtimi të tillë¹. Thënë shkurt, nëse pronari i ri do të donte t'i ndryshonte planet e miratuara të investimeve, ZRRE do t'i shqyrtonte propozimet e tyre në atë moment. Kriteri kyç të cilin ZRRE do të merrte parasysh në miratimin e modifikimeve është nëse ndryshimet do të ofrojnë përfitim të njëjtë (apo më të madh) për konsumatorë për të njëjtën kosto. Megjithatë, nuk është e qartë nëse Çalik-Limak propozon të rris nivelin e investimit përtej atij të propozuar nga KEK-u. ZRRE vë në pah që zotimi i Çalik-Limakut për të investuar rreth €300 milionë në periudhë prej 15 viteve nuk është më i madh sesa që KEK-u historikisht ka shpenzuar (dhe konsumatorët e Kosovës kanë paguar).

2.2.2 Çalik-Limak sugjeron që kostot për njësi duhet të jenë ato që propozon kompania

Rivlerësimi i kostove për njësi, ashtu siç është përshkruar më lartë, ka rezultuar në një lejim prej €107.2m bazuar në koston për njësi të arritur dhe të kontraktuar nga KEK-u.

¹ ZRRE: SHTE7 "Raporti i l-rë konsultativ", 11 qershor 2012, pjesa 2.2

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

2.2.3 Kërkesa për vlerën e plotë, të Investimeve kapitale të propozuar


Çalik-Limak kanë sugjeruar që ZRRE duhet thjeshtë të lejojë shumën e plotë të Investimeve kapitale të kërkuar nga KEK-u ata thonë që, nëse të hollat mbesin të pashpenzuara, ata do t'i përdorin kursimet për projektet shtesë, gjë që është mirë për sistemin.

ZRRE është në dijeni që KEK-u historikisht ka investuar më pak se sa që është e nevojshme në sistem. Ndërkohë, ZRRE pret që i licencuari të planifikojë dhe të zbatojë projekte kapitale në një mënyrë efikase dhe kost-efektive, dhe në kërkim të kursimeve, nuk do të ishte e përshtatshme për konsumatorët që të pranohet lejim më i lartë për shpenzime kapitale sesa ai që arsyetohet aktualisht kundrejt një synimi të paqartë për të rritur performance në të ardhmen.

2.3 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së i shpenzimeve kapitale të OSSH-së

Plani për zhvillim të rrjetit (PZHRR) i OSSH-së është shqyrtuar nga ZRRE së bashku me konsulentët teknik të saj dhe vlerësimi është dhënë në raportin e dhjetorit 2012. SKM ka rekomanduar që projektet e cekura në PZHRR janë të qëlluara dhe të domosdoshme. ZRRE e pranon këtë rekomandim dhe prandaj vendosë për përfshirjen e ketyre projekteve të propozuara në shpenzime kapitale kur të përcaktohet MAR-i për periudhën e ardhshme të kontrollit, por me kosto më të ulët për njësi, të cekur në pjesën 2.1 më lartë. Shpenzimet kapitale të lejuara përfundimisht nga ZRRE-ja të dhënë në Tabelën a më lartë, dhe Figura 1 në vijim tregojnë raportin ndërmjet kërkesës së KEK-ut për shpenzimet kapitale, Lejimin e përkohshëm të ZRRE-së dhe Lejimin përfundimtar të ZRRE-së.

Figura 1



3 Vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve operative të propozuara të OSSH-së

Që nga parashtrësia fillestare më 31 gusht, OSSH-ja ka parashtruar shpenzimet e tyre operative përmes një numri të parashtrësive pas takimeve pasuese qartësuese ndërmjet KEK-ut dhe ZRRE. Duhet të ceket që shpenzimet totale operative të KEK-ut ndërmjet parashtrësive të para dhe atyre të nëntorit janë ulur për €4.4m.

Si KEK-u ashtu edhe Çalik-Limak janë deklaruar kundër Vlerësimit të përkohshëm të ZRRE-së për një numër të zërave të shpenzimeve operative. Këto diskutohen në pjesët vijuese.

3.1 Pagat dhe kostot e ndërlidhura

KEK-u fillimisht ka paraparë një rritje reale vjetore të pagave mesatare prej 5% në të gjitha njësitë afariste (dhe jo vetëm OSSH dhe FPEE). KEK-u fillimisht sugjeroi që kjo bëhet për të rritur koston për punëtor mbi Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumatorit (Harmonized Index of consumer Prices (HICP)) për periudhën 2008-2011 prej 5.4%, që është për së afërmi në përputhje me Indeksin e Çmimeve të Konsumatorit (IÇK) në Kosovë. Komentet në vijim vlejnjë njësoj për bizneset e FPEE-së, të mihjes dhe të prodhimit të KEK-ut.

3.1.1 Parashtrësia e KEK-ut për paga dhe kosto të ndërlidhura

Parashtrësia e KEK-ut me 4 shkurt synon të arsyetojë rritjen e propozuar reale të koston së pagave duke pohuar që kërkesa e Qeverisë që punëdhënësit të paguajnë kostot shëndetësore të stafit do të kërkojë një rritje prej 2% nga viti 2014. KEK-u pohon që kostot aktuale në vitin 2012 janë më të larta sesa ato të lejuara nga ZRRE në vitin 2012, dhe se këto duhet të merren parasysh si pikënisje. Këto kosto duhet të rriten për 3% në vitin 2013, me rritje prej 5% më tej, për të pasqyruar obligimin e kostove shëndetësore.

3.1.2 Parashtrësia e Çalik-Limak për pagat dhe kostot e ndërlidhura

Çalik-Limak pohon që pagat bazë të KEK-ut nuk janë rritur që nga viti 2008, dhe se rregullimi i propozuar ishte i nevojshëm në mënyrë që pagat e 2013 të sillleshin në nivelin real të atyre të vitit 2008. Ata gjithashtu deklaruan se dëshirojnë të vënë në zbatim një skemë motivimi për stafin, pjesërisht për të stimuluar uljen e humbjeve dhe pjesërisht për të pasqyruar zhvillimin e stafit.

Në parashtrësien e tyre, ata kanë kërkuar një lejim shtesë për koston e pagave, mbi atë të kërkuar nga KEK-u.

Tabela b

Kërkesa shtesë e Çalik-Limak për kostot e pagave për OSSH dhe FPEE të KEK-ut	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	2017 € 000's	Total € 000's
Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së	14,530	14,530	14,530	14,530	14,530	72,650
Parashtrësia e Çalik-Limakut	16,649	18,736	20,079	21,521	23,072	100,057
Dallimi %	15%	29%	38%	48%	59%	38%

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

3.1.3 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për pagat dhe kostot e ndërlidhura

Në përcaktimin e lejimit të vitit 2012 për kostot e pagave, ZRRE ka lejuar vlerën e plotë të kërkuar nga KEK-u për SHTE6. Po ashtu vlenë të theksohet se, vet parashtresat e KEK-ut kanë bërë me dije që pagat janë rritur çdo vit dhe se pohimi i Çalik-Limakut për mos rritje të pagës që nga viti 2008 supozohet se bazohet në një keqkuptim.

Roli i ZRRE-së gjatë përcaktimit të MAR-it është se duhet të lejojë një nivel të arsyeshëm për kostot e pagave të cilat duhet t'iu kalohen konsumatorëve përmes tarifave. I takon menaxhmentit të kompanisë të përcaktojë nivelet e pagave. Nëse KEK-u dëshiron të paguajë stafin e vet më shumë se sa ky lejim, atëherë mund ta bëjnë këtë, por duhet të gjejë fitime eficiente të sinqerta nga diku tjetër për të paguar këtë. Prandaj, ZRRE propozon që të përdoret vlera e lejuar me SHTE6 për vitin 2012 si një pikënisje e qëlluar për parashikimin e pagave.

Ngjashëm, në përgjigje të propozimit të Çalik-Limak për ri-rregullim të pagave, ZRRE konsideron se i takon menaxhmentit të ri që të vë në zbatim çfarëdo stimulime të reja apo skema motivuese të cilat i konsideron të duhura. Mirëpo, ZRRE është e mendimit që, në përputhje me natyrën e skemave të tyre, ata vetë duhet të gjejnë mjete përmes kursimeve të cilat i akumulohen biznesit. Nuk është e drejtë që konsumatorët të paguajnë për këto skema.

Aktualisht, propozimet e Qeverisë përkitazi me kostot e sigurimeve shëndetësore të të punësuarve ende nuk janë në zbatim ligjor. Ashtu si edhe me taksën për shfrytëzim të linjitet, ZRRE duhet të merr parasysh çfarëdo ndryshimesh në ligj. Në rast se ky ligj hyn në fuqi, ZRRE do ta shqyrtojë situatën dhe do bëjë të gjitha ndryshimet e nevojshme, duke i marrë parasysh të gjithë faktorët relevant në atë moment. Megjithatë, do të ishte e parakohshme që kjo kosto t'iu kalohet konsumatorëve deri sa ligji ende nuk është në fuqi.

Prandaj, ZRRE vlerëson se nuk ka arsyetim për rritjet reale të kostos së pagave për periudhën e ardhshme, dhe lejon që niveli i kostove për këto kategori të shpenzimeve të mbeten në nivelin e aprovuar të vitit 2012 si dhe një rritje prej 60,000 eurosh në vit për shpenzimet e personelit për shkak se pas ndarjes së biznesit, disa pozicione të stafit, kryesisht ato të menaxhimit, duhet të dyfishohen.

3.2 Riparimet dhe mirëmbajtja

Në përgjigje të raportit konsultativ të ZRRE-së lidhur me Vlerësimin e përkohshëm, si KEK-u ashtu edhe Çalik-Limak, pohuan se niveli i aprovuar i ZRRE-së për vitin 2012 ishte dukshëm nën nivelin e shpenzimeve aktuale në atë vit. Ata pohuan se shpenzimet aktuale të vitit 2012 prej €7.14 milionë ishin bazë më e mirë për të paraparë shpenzimet për pjesën tjetër të periudhës kontrolluese, për dallim nga vlera e lejuar prej €4.9 milionë.

ZRRE brengoset lidhur me trendin e shpenzimeve për riparime dhe mirëmbajtje, dhe për efektin që mund të ketë zgjedhja e një viti për të definuar bazën e kostos për këtë kategori të shpenzimeve. Në shqyrtimet paraprake të tarifave, ZRRE ka aprovuar kërkesën e plotë për riparimet dhe mirëmbajtjen të parashtruar nga kompania për arsye se rrjeti elektrik ka qenë në gjendje të dobët. Mirëpo, KEK-u vazhdimisht ka shpenzuar më pak se sa kostot e lejuara, përveq dy vitet e fundit, dhe ZRRE ka

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

rregulluar lejimin përfundimtar , pikërisht për shumat e pashpenzuara nga KEK-u e të cilat ju janë lejuar përmes tarifave.

Prandaj niveli i lartë i shpenzimeve të raportuara në vitin 2012 është në shpërputhje me shpenzimet e viteve paraprake. ZRRE ka kërkuar arsytim shtesë nga KEK-u për të arsyetuar nivelin shumë të lartë të shpenzimeve të raportuar në vitin 2012. KEK-u ka konfirmuar shpenzimet prej €7.14 milionëve por nuk ishte në pozitë të ofrojë detaje se për çka janë shpenzuar të hollat. ZRRE arrin në përfundim se sistemet menaxhuese të KEK-ut për monitorim dhe kontrollim të shpenzimeve për riparime dhe mirëmbajtje janë të mangëta. Në veçanti, KEK-u nuk duket se kryen vlerësim të kostos bazuar në aktivitet, gjë që do t'i mundësonte të ofrojë një shpenzim dhe arsytim për lloje të ndryshme të aktiviteteve për riparim dhe mirëmbajtje.

Në mungesë të të dhënave mbështetëse nga i licencuari, ZRRE beson se lejimi i bazuar në të dhënat historike të kostove të rregulluara gjatë pesë viteve të fundi është një bazë e qëlluar për parashikimet për periudhën e TSHV-së. Konsulentët teknik të ZRRE-së i kanë vlerësuar këto shpenzime historike dhe kanë ofruar një game të vlerave të parashikimit, duke përdorur një rritje vjetore të ndërlidhur me rritjen në rrjet. Lejimet përfundimtare të ZRRE-së për riparime dhe mirëmbajtje janë dhënë në Tabelën C në vijim. Lejimi për periudhën e TSHV-së janë dukshëm më të larta se sa ato të përfshira në Propozimet e përkohshme të ZRRE-së.

Tabela c

Kostoja e R & M - OSSH-së	2012 € 000's	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	2017 € 000's	Total € 000's
Parashikimi i KEK-ut (Nëntor 2012)	4,905	5,101	5,305	5,517	5,738	5,968	27,629
Parashikimi i ndryshuar i KEK-ut (& Calik Limak) (Shkurt 2013)	7,153	7,439	7,737	8,046	8,368	8,703	40,293
Propozimi i përkohshëm i ZRRE-së (Jan 2013)	4,905	4,977	5,049	5,123	5,198	5,274	25,621
Propozimi përfundimtar i ZRRE-së (Shkurt 2013)		6,218	6,339	6,463	6,589	6,717	32,326

3.3 Opex-i tjetër i kontrollueshëm

Vlerësimi i ZRRE-së lidhur me kategoritë e tjera të zbërthyera të shpenzimeve operative të OSSH-së kanë mbuluar zëra vijues:

- Karburant;
- Shpenzimet tjera

Në Vlerësimin e vet të përkohshëm, ZRRE-ja ka vënë në pah se këto shpenzime do të vareshin në masë të madhe nga numri i stafit dhe jo nga numri i konsumatorëve. Pasi që OSSH KEK nuk parasheh ndonjë rritje në numrin e stafit gjatë Periudhës Rregullative, ZRRE-ja rekomandon që këto lejime të mbesin në nivelin e vitit 2012. KEK-u pohon se kostoja e karburantit do të rritet me numrin e konsumatorëve. ZRRE nuk e pranon këtë. Mund të jetë sipërfaqësisht atraktive të supozohet që numrat e konsumatorëve janë një shtytës i madh i kostove të karburantit. Mirëpo, në praktikë, është

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

konstatuar nga rregullatorët gjetiu se shtytësi kryesor i kostove të tilla është gjatësia e rrjetit dhe jo numri i konsumatorëve. Rrjedhimisht, ZRRE nuk sheh arsyetim për ndryshim të vlerësimit të përkohshëm.

3.4 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për propozimet e shpenzimeve operative të OSSH-së

Për veprimtarin e OSSH-së, ulja e rekomanduar e kostove të kontrollueshme është €6.9m gjatë periudhës rregullatore, gjë që përfaqëson 7.9% zbritje të kostove të kontrollueshme. Opex-i i kontrolluar përjashton Opex-in e ndërlidhur me Zhvlerësimin dhe Amortizimin, i cili klasifikohet si jo i kontrollueshëm dhe vlerësimi përfundimtar i kësaj varet nga niveli i lejuar i Investimeve kapitale.

Tabela d

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së i për opex-in e kontrollueshëm të OSSH-së	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	2017 € 000's	Total € 000's
I kontrollueshëm	16,319	16,440	16,563	15,854	15,184	80,360
I pa kontrollueshëm	6,522	7,261	8,016	8,736	9,376	39,911
Gjithsej	22,840	23,700	24,579	24,591	24,561	120,271

4 Vlerësimi përfundimtar i Shpenzimeve të propozuara kapitale të FPEE-së

Biznesi i FPEE-së nuk është shumë intensiv për nga asetet dhe shpenzimet e propozuara kapitale të Kompanis nuk janë domethënëse. Shuma e propozuar është në përputhje me nivelet historike të shpenzimeve. ZRRE-ja ka propozuar që shpenzimet e propozuara të lejohen në tërësi. Ky vlerësim ka qenë edhe gjatë dhënies së vlerësimit të përkohshëm, dhe ky qëndrim nuk ka ndryshuar. Shpenzimet përfundimtare kapitale janë dhënë në tabelën vijuese.

Tabela e

Vlerësimi përfundimtar i Sh. Kapitale të FPEE-së	Capex-i vjetor (€)
Kompjuterët për departamentin e kujdesit të konsumatorëve	
Furnizimi i printerëve për fakturim	
Printerët për arka	
Furnizimi i aparateve për fotokopjim	
Automjete	
Gjithsej Capex-i vjetor	395,000

5 Vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve të propozuara operative të FPEE-së

Zërat kryesorë të kostos operative të FPEE-së, ashtu siç tregohet në *Tabelën e.1* në vijim diskutohen në këtë seksion. Mirëpo, përveç kësaj, parashtresa e Çalik-Limakut e 4 shkurtit kërkoi kosto operative shtesë që do të pasqyrojnë kostot e ndarjes së biznesit nga Gjenerimi dhe Mihja e KEK-ut, si dhe disa kosto drejtpërdrejti të ndërlidhura me ndërrimin e pronarit. Këto kosto të ndarjes së biznesit diskutohen në pjesën 5.4 në vijim.

Tabela e.1

Opex-i i Lejuara i FPEE-së	2013-2017 €m
Pagat	43.17
Zhvlerësimi	2.00
Mirëmbajtja, riparimi dhe materialet/furnizimet	4.10
Kostot jtera	15.03
Gjithsej	64.30

5.1 Niveli i stafit

Parashtresa e Kompanisë propozon që stafit i FPEE-së të mbetet në nivelin aktual prej 1,380. Janë rreth 32 pensionime që janë paraparë për periudhën 5 vjeçare të TSHV-së, të cilët nuk janë përfshirë në numrin e paraparë të stafit.

Rritja e numrit të konsumatorëve çdo vit prej rreth 3% do të duhej të vepronte si shtytës për rritjen e numrit të stafit të FPEE-së. Plani i KEK-ut për të fiksuar numrin në nivelin aktual ka një efikasitet të sendërtuar prej rreth 3%.

5.2 Paga dhe kostot e ndërlidhura

KEK-u dhe Çalik-Limak i kanë ofruar ZRRE-së parashtresa të tjera lidhur me nivelet e pagave pas konsultimit të janarit lidhur me Vlerësimin përkohshëm të ZRRE-së. Këto diskutohen në raport me OSSH-në në pjesën 3.2 më lartë. Komentet e njëjta, dhe përgjigja e ZRRE-së për këto komente, vlejné edhe për FPEE-në. ZRRE nuk sheh arsye që të ndryshojë Vlerësimin e vet të Përkohshëm, dhe kostot e pagave, do t'i mbajë shpenzimet në nivelet e vitit 2012 me një rritje prej 60,000 eurosh në vitë sikurse tek OSSH-ja për shpenzimet e personelit për shkak të shturjes.

5.3 Riparimet dhe mirëmbajtja

KEK-u dhe Çalik-Limak kanë bërë propozime të mëtejshme në lidhje me kostot e riparimit dhe mirëmbajtjes në përgjigje të Vlerësimin të Përkohshëm të ZRRE-së. Të dyja përgjigjet sugjeruan që duhet të përdoren kostot aktuale të vitit 2012 si kosto elementare dhe kjo pastaj duhet të rritet çdo vit në proporcion me ndryshimin e numrit të konsumatorëve. ZRRE-ja e pranon se lejimi duhet të rritet në përputhje me numrin e konsumatorëve, por mbetet e mendimit se kostoja e propozuar bazë

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

në Vlerësimin e Përkohshëm është e përshtatshme. Tabela f në vijim tregon detajet e shpenzimeve për R & M të propozuar nga KEK-u dhe C-L, së bashku me Lejimet e përkohshme dhe përfundimtare të ZRRE-së. Lejimi Final për periudhën TSHV është 9.4% më i lartë se vlera e Lejimit të Përkohshëm.

Tabela f

Kostot operative të R&M (FPPE)	2013	2013	2014	2015	2016	2017	Total
	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	
Parashikimi i ndryshuar i KEK-ut (shkurt 2013)	870	896	923	951	979	1,008	4,757
Parashikimi Çalik Limak (Jan 2013)		866	903	933	964	989	4,655
Propozimi i përkohshëm i ZRRE-së (Jan 2013)	592	592	592	592	592	592	2,960
Lejimi përfundimtar i ZRRE-së		610	628	647	666	686	3,237
% e rritjes së lejimit përfundimtar krahasuar me Lejimin e përkohshëm		3%	6%	9%	13%	16%	9%

5.4 Kostot tjera të kontrollueshme

Parashtresa e FPPE KEK propozonte “Opex-in tjetër të kontrollueshëm” sipas zëreve vijuese, dhe këtu janë dhënë krahasimet e rritjes së tyre vjetore të kostos:

Tabela g

Kategoria	2013	2014	2015	2016	2017
	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's
Karburantet	566	566	566	566	567
Shpenzimet tjera	2,392	2,392	2,392	2,392	2,392
Gjithsej	2,959	2,959	2,959	2,959	2,959

Ngjashëm si me qasjen e OSSH-së KEK, është vërejtur se këto zëre janë paraparë nga KEK-u për t'u rritur nga viti në vit nga vlerat e vitit 2012, ku rritja e përqindjes është e lidhur me rritjen e parashikuar të numrit të konsumatorëve.

Si me shpenzimet e tjera të kontrollueshme, ZRRE-ja konsideron se këto shpenzime (si për OSSH, të diskutuar në pjesën 3.4 më sipër) në masë të madhe do të varet nga numri i stafit dhe jo numri i konsumatorëve. Pasi që FPPE-ja e KEK-ut nuk parasheh ndonjë rritje në numrin e stafit gjatë periudhës 5-vjeçare të TSHV-së, ZRRE propozon që këto kosto të mbesin në nivelin e vitit 2012.

5.5 Parashtresa e Çalik-Limak lidhur me shturjen

Në parashtresën e saj ZRRE-së të 31 janarit, Çalik-Limak ka cekur argumentet e veta për të mbështetur një lejim shtesë prej €37.8m mbi Vlerësimin e përkohshëm të ZRRE-së për keto kosto. Kompania cek se ky lejim shtesë nevojitet për të mbuluar kostot që kanë të bëjnë me shturjen e bizneseve të distribucionit dhe furnizimit të KEK-ut, dhe për disa kosto drejtpërsëdrejti të lidhura me

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

blerjen

e

biznesit.

Propozimet e Çalik - Limak për kostot shtesë të shthurjes	2013 € 000'S	2014 € 000'S	2015 € 000'S	2016 € 000'S	2017 € 000'S	Total € 000'S
Kostot e pagave (5% 2013, 7.5 % në vazhdimësi)	3,991	4,086	4,392	4,722	5,076	22,267
Sigurimi Shendetësorë		108	108	108	108	432
Materiale dhe furnizime	356	383	380	380	380	1,879
Shërbime Kontraktuese	1,103	1,165	1,165	1,165	1,165	5,763
Shpenzime të tjera	1,220	1,474	1,624	1,769	1,934	8,021
Mirëmbajtje	287	324	324	364	394	1,693
Totali i kostove të HQ gjatë shthurjes	6,957	7,540	7,993	8,508	9,057	40,055
Konsulenca dhe taksat	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000
Shpenzimet totale të shthurjes për HQ	9,957	10,540	10,993	11,507	12,056	15,000
pa Alokimin e propozuar të HQ nga ZRRE	3,489	3,489	3,489	3,489	3,489	17,445
Kosot shtesë dhe te pashmangshme për shthurje	6,468	7,051	7,504	8,018	8,567	37,608

ZRRE e kishte të pamundur të harmonizojë kostot e pagave të cekur këtu nga Çalik-Limak me ato të shfaqura gjetiu në parashtresën e tyre. Ata i ngritën tre lëmi të gjëra të kostos të cilat pohojnë se duhet të shtellohen, dhe këto diskutohen në këtë pjesë.

5.5.1 Pagat

Çalik-Limak pohojnë se pas ndarjes së biznesit, disa pozicione të stafit, kryesisht ato të menaxhimit, duhet të dyfishohen. ZRRE-ja e pranon se kjo është e saktë dhe ka lejuar një vlerë e cila është e cekur me lartë. Vlenë të theksohet se disa nga pozicionet kyçe të menaxhimit në Distribucion dhe Furnizim të KEK-ut do të plotësohen nga stafi i transferuar nga pozicionet e krahasueshme në KEK, megjithëse me një fushëveprim më të vogël të përgjegjësisë.

5.5.2 Opex-i tjetër

Çalik-Limak pohojnë se disa kosto të centralizuara operative nuk duhet të rialokohen në baza të propozuara nga KEK-u, i cili është në proporcion me numrin e stafit në divizione. Ata identifikojnë një numër të shërbimeve qendrore ku ata propozojnë një ndarje alternative të kostos. ZRRE nuk ka mundur të barazojë numrat e ofruara nga Çalik-Limak në parashtresën e tyre me kostot e ofruara paraprakisht nga KEK-u .

Ishte e qartë gjatë shqyrtimit SHTE7 që sistemi i brendshëm i kontabilitetit i KEK-ut nuk lejon aktualisht një analizë të hollësishme të kostove individuale. Prandaj, ZRRE konsideron se metodologjia e propozuar nga KEK-u përfaqëson një qasje pragmatike dhe të arsyeshme në ndarjen e kostove të centralizuara dhe të ndara.

5.5.3 Kostot e konsulencës

Çalik-Limak deklarojnë që Shpërndarja dhe Furnizimi i KEK-ut do të vazhdojnë të kenë nevojë domethënëse të shërbimeve të jashtme prej rreth € 3m në vit, ose € 15m gjatë periudhës së re të kontrollit. Ata thonë që këto shërbime përfshijnë “transferin e dijes, politikave, këshillave dhe ndihmës në përgatitjen e planit të zhvillimit të rrethit 5 dhe 10 vjeçar, praktikave dhe shfrytëzimi i përvojës nga burimet e shumta, duke përfshirë TI, prokurim, riorganizim të procesit.” Përveç shumës prej € 3m në vit, ZRRE vë në pah se “kostot e ndarjes së AQ” të

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

propozuar nga kompania në parashtresën e tyre tashmë përmbajnë një element të konsulencës.

KEK ka përfituar nga mbështetja e konsulencës në menagjim për gati 10 vite. Pasiqë kjo mbështetje ka qenë e financuar nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, kjo nuk është përfshirë si kosto në tarifë. ZRRE nuk pranon që konsumatorët duhet të paguajnë tani për menaxhim komercial dhe konsulencë të sektorit energjetik. Konsumatorët mund të presin që pronari i ri i KEK Shpërndarjes dhe Furnizimit të sjellë këto njohuri në Kosovë si njëra nga përfitimet e privatizimit të saj. Prandaj ZRRE nuk lejon që këto kosto të futen në Të hyrat maksimale të lejuara. Ky vendim nga ana tjetër nuk duhet ta ndalojë menaxhmentin e ri nga prokurimi për të siguruar mbështetje nga jashtë, e cila natyrisht se duhet të paguhet nga fitimi i pronarit ose nga ndonjë donacion.

5.6 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së lidhur me propozimet e FPEE-së për shpenzimet operative

KEK-u ka paraparë që këto kosto duhet të rriten çdo vit për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve.

Për Aktivitet e FPEE-së, reduktimi i propozuar për kostot e kontrollueshme është €9.4m gjatë periudhës rregullative, që paraqet diku rreth 13% zbritje të kostove të kontrollueshme në total. Vlenë të theksohet se Zhvlerësimi dhe amortizimi, ngarkesat për transimion të energjisë elektrike dhe ngarkesat për shpërndarje të energjisë elektrike klasifikohen si elemente të pa-kontrollueshme të opex-it; vlerat e tyre përcaktohen nga vlera e lejuar e MAR-it per Transimion perkatesisht Shpërndarje dhe nuk janë përfshirë në parashtresën e opex-it për FPEE-së.

Tabela g

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të opex-it të kontrollueshëm të FPEE-së	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	2017 € 000's	Total € 000's
Të kontrollueshme	12,423	12,441	12,460	12,479	12,500	62,302

6 Parametrat e tjerë rregullativ

6.1 Lejimi për humbje

ZRRE-ja ka përcaktuar nivelin e humbjeve i cili mund të rikthehet përmes tarifave të rregulluara bazuar në Vendimin e ZRRE-së 399 të 6 shkurtit 2012. Duke ju referuar këtij vendimi, ZRRE ka ulur nivelin e lajuar të humbjeve për 3% (pikë përqindje) nga niveli i lejuar në SHTE6 në 27.4% për SHTE7.

Në përgjigjen e tyre të 4 shkurtit ndaj konsultimit për Vlerësim të përkohshëm të ZRRE-së, Çalik-Limak, kërkoi ndryshim të Lejimit të para-caktuar të humbjes pasi që KEK-u nuk ia ka dalur mbanë të zvogëlojë humbjet në përputhje me cakun e vet të vitit 2012. ZRRE-ja ka marrë vendimin e saj të shkurtit 2012 pas shkresave nga Qeveria e Kosovës dhe nga Këshilltari i Transaksionit për distribucion dhe furnizimit, IFC, në mënyrë që të ul pasigurinë rregullative dhe të jep një bazë të fort tenderuesve

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

kundrejt së cilës mund të ofertojnë. Dështimi i mundshëm i KEK-ut për të përmbushur cakun ishte një rrezik për të cilin ishin të njoftuar Çalik-Limak kur kanë kërkuar parametrat rregullative të para-caktuara, dhe ZRRE-ja supozon se kjo është përfshirë në çmimin e saj të ofertimit.

6.2 Faktori i ndarjes së humbjeve

Faktori i ndarjes së humbjeve është përcaktuar në bazë të Vendimit të ZRRE-së 399, të 6 shkurtit 2012 në 0%. Me këtë nënkuptohet që çfarëdo fitime apo humbje të cilat nxirren nga ulja e humbjeve për më shumë apo më pak se caku i ZRRE-së barten nga OSSH-ja.

6.3 Faktori i efikasitetit

Faktori efikasitetit për tre vitet e para të periudhës rregullative është vendosur në bazë të vendimit të ZRRE-së 399, i 6 shkurtit 2012 në 0%. ZRRE-ja propozon që faktori efikasitetit për dy vitet e fundit të periudhës rregullative të jetë 5% në vit.

6.4 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (MPKK)

Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (MPKK) për OSSH-në është përcaktuar sipas Vendimit të ZRRE-së 399, të 6 shkurtit 2012. Sipas këtij vendimi, MPKK që vlen për OSSH-në për periudhën e ardhshme rregullative duhet të jetë 12% (real, para-tatimit).

7 MAR-i përfundimtar 2013-2017

MAR-i përfundimtar për divizionin e OSSH-së ku përfshihen kostot e O&M, zhvlerësimi, kthimi i lejuar, blerja e humbjeve si dhe agjustimet për humbjet e vitit 2012 në vlerë prej €1.9m është përmbledhur në tabelën vijuese:

Tabelah

Vlerësimi përfundimtar i MAR për biznesin e licencuar të OSSH-së	2013 €m	2014 €m	2015 €m	2016 €m	2017 €m	Total €m
Gjithsej	70.19	67.93	67.72	66.05	65.84	337.73

MAR-i përfundimtar për divizionin e FPEE-së ku përfshihen kostot e O&M, zhvlerësimi, marzha e shitjes me pakicë, kostoja e kapitalit punues, borxhet e këqija është përmbledhur në tabelën vijuese, ndersa kostot e lejuara të blerjes së energjisë elektrike si dhe kostot e bartura të cilat perfshijnë ngarkesat e OST/OT dhe ngarkesat e DUOS janë prezantuar në “VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR – PASQYRË”

Tabela i

Vlerësimi përfundimtar i MAR për biznesin e licencuar të FPEE-së	2013 €m	2014 €m	2015 €m	2016 €m	2017 €m	Total €m
Gjithsej	14.97	32.91	30.93	31.27	32.26	142.35

Vlerësimi përfundimtar – në detaje i OSSH-së

Nga tabela shihet një ndryshim i madh në mes të vitit 2013 dhe viteve tjera, i cili rrjedhë për shkak të agjustimeve për Import, Eksport dhe për vonesën e hyrjes në fuqi të vendimit për tarifa të vitit 2012, e të cilat duhet të bartën në vitin 2013. Vlera neto e këtyre agjustimeve është € -17.9m.